



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 14, të Ligjit mbi tokën ndërtimore (Gazeta Zyrtare e Kosovës) nr. 4/80), dhe të nenit 32, pika 32.1, shkronja e të Statusit të Komunës së Prishtinës, më dt. 31.03.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur 29.10.2008 merr:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT DHE SHPALLJEN E INTERESIT TE PERGJITHSHEM TE NGASTRES KADAST. NR. 414/0 ZONA KADASTRALE KOLIQ PER NDERTIMIN E SHKOLLES FILLORE "TEFIK ÇANGA" NE FSHATIN KOLIQ KK PRISHTINES

Neni 1

1.1 Miratohet vendimi për shpalljen e interesit te përgjithshëm te ngast. kat. nr. 414/0 e evidentuar në fletën poseduese nr. 71912039, Zona Kadastrale Koliq, me pronar Kamer Shaqiri, për ndërtimin e shkollës fillore ne fshatin Koliq KK Prishtinës.

1.2 Lokacioni nga alineja 1 e këtij neni përfshin pjesën e ngastrës kadastrale 414/0, ne sipërfaqe prej 0.10,00 ha Zona kadastrale Koliq KK Prishtine.

Neni 2

Procedura e eksproprijimit të tokës të përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi dhe kompensimit do të zhvillohet nga Drejtoria për Pronë i Komunës së Prishtinës.

Neni 3

3.1 Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesët Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

3.2 Nga aspekti i realizimit të lokacionit do të kujdesët Drejtoria i Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr. 353-1602 Dt. 29.10.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof dr. Isa Mustafa